

An overview of Gjon Buzuku’s “Meshari” Lexicon

Abstract: *The article commemorates the 470th anniversary of the day when the parish priest Gjon Buzuku began to work on “Meshari” (Missal, March 20, 1554), widely known as the earliest book in Albanian. He finished it on January 5, 1555, which is also considered the year of its publication (the frontispiece with notices about place and year of publication have not been preserved). The article deals with the lexicon of “Meshari”, which consists of about 3200 words. These are the first evidence on which scholars can rely to consider the state of the Albanian vocabulary in the middle of the 16th century and, among other things, the relations of Albanian with the neighbouring languages, the geography of the words and their semantic development. In particular, the authors draw attention to Buzuku’s efforts in order to elevate the spoken Albanian of his time to the level of a written language and to create the layer of its erudite and culture lexemes. Further on, the authors bring about observations and assessments on issues such as the origin of words (either native or borrowed), their diffusion (general and regional words), neologisms, types of words from the point of view of their formation (distinguishing the most productive prefixes and suffixes and types of composites, which are not numerous). Lastly, an overview of the thematic areas of the lexicon (with relevant statistics) is provided, intending to offer evidence on the state of the Albanian lexicon in the 16th century as it appears in the “Meshari”.*

Keywords: *(inter)dialectal words, word formation, thematic area, lexicon, translation, Holy Scripture.*

1. Kur Gjon Buzuku u ul e filloi veprën e tij më 20 mars 1554, s’ka dyshim se vendimin e kishte marrë që më parë, pasi e kishte bluar e përbluar punën që e priste për atë që ai vetë e quan “mā e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë”. Vështirësia e parë dhe kryesore për një përkthyes është që të gjejë në gjuhën e përkthimit fjalët e më të përshtatshme për të dhënë kuptimin e fjalëve të origjinalit. Buzuku si meshtar e njihte mirë përmbajtjen e veprës që do të përkthente, po ashtu

fjalët e origjinalit. Është afërmendsh të besohet se ai dhe meshtarë të tjerë shqiptarë kishin përkthyer me vetveten, ndoshta edhe gojarisht për të tjerë, pjesë të ndryshme nga librat latinisht të kishës. Buzuku, pra, i hyri punës së përkthimit me besim se gjuha e tij amtare do t'ia jepte fjalët e nevojshme që i duheshin. Kjo do të thotë, sipas mendimit tonë, se gjuha shqipe në mesin e shekullit XVI, përveçse gjuhë e nevojave të përditshme të komunikimit të gjindes analfabete, ishte edhe gjuhë e komunikimit të një shtrese të shkolluar, që sado pak e kishin përpunuar ligjërimin e tyre, edhe në mënyrë të pavetëdijshme, në ballafaqim me gjuhët e tjera që njihnin. Me fjalë të tjera në mesin e shekullit XVI mund të thuhet leksiku i shqipes “që pjekur” për të përballuar përkthimin e Shkrimit të Shenjtë.

Ndër studimet e shumta për gjuhën e veprës së Buzukut, siç dëshmon dhe bibliografia në fund të vëllimit të botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë me rastin e 450-vjetorit të “Mesharit”, studimet për leksikun janë më të pakta¹. Mungon një punim sintetik e tërësor për fjalorin e këtij autori, ashtu siç kemi për fonetikën dhe për format gramatikore të tij. Prof. E. Çabej të dhënat e Buzukut i ka përdorur sidomos në studimet e tij etimologjike si mbështetje për të shkuar shkallë-shkallë te forma dhe kuptimi i kryehershëm i fjalës. Nxjerrja e leksikut të plotë të “Mesharit” nga Kolë Ashta² është një mbështetje e mirë, ndonëse jo e mjaftueshme për studime në këtë fushë. Ndër 2127 fjalët që ka numëruar ky studiues i rysur i leksikut historik të shqipes, sipas një llogaritjeje të përafërt fjalët emërtuese³ me të cilat do të merremi në këtë kumtesë, janë rreth 1935 dhe nga këto: 940 emra, 384 mbiemra, 493 folje e 118 ndajfolje. Një punë e re me shumë vlerë në këtë drejtim është edhe vëllimi “Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut (me rreth 3200 fjalë, 350 emra të përveçëm, dhe 260 fjalë e shprehje latinisht)”, i hartuar nga dr. Thoma Qendro (Botuar nga: Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë. Tiranë, 2013, 526 f.). Të dyja këto botime, bashkë me botimin kritik të “Mesharit” nga E. Çabej dhe hyrjen e tij studimore, kanë qenë burimi nga është vjelë lënda e këtij artikulli.

Studimi i leksikut të “Mesharit” është me rëndësi në disa drejtime. Së pari, ai përfaqëson dëshminë e vetme për përbërjen e leksikut të shqipes së Shqipërisë në mesin e shekullit XVI. Së dyti, pasuria leksikore e “Mesharit” hedh dritë mbi marrëdhëniet e shqipes që sapo fillonte të shkruhej, me gjuhët fqinje dhe ndihmon për të mbështetur këtë ose atë hipotezë rreth

1 *Buzuku dhe gjuha e tij*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2005, 456 f.

2 Shih: “*Leksiku historik i gjuhës shqipe*” I. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Shkodër, 1996, f. 244-494.

3 Të tilla quhen fjalët që emërtojnë sende (emrat), cilësi (mbiemrat), veprime si procese (foljet), dhe rrethana (ndajfoljet). Khs. *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I Morfologjia*. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2002, f. 38.

enigmave të pazgjidhura të “Mesharit” e të autorit të tij⁴. Së treti, në leksikun e “Mesharit” shprehen më qartë përpjekjet dhe arritjet e Gjon Buzukut për ta ngritur shqipen e folur të kohës së tij në shkallën e një gjuhe shkrimi dhe për të mbrytur shtresën e fjalëve diturore e librore të saj. Së katërti, për të ndjekur gjeografinë e përhapjes dhe zhvillimet semantike të fjalëve. Në këto fusha mendojmë se ka ende mjaft punë për të bërë.

2. Leksiku i “Mesharit” mund të thuhet se mbështet me të dhënat e tij disa karakteristika të përgjithshme të gjuhës së veprës, që dalin nga shqyrtimi i veçorive fonetike e gramatikore të saj. Te kjo vepër dalin një varg fjalësh, që dëshmojnë se edhe nga pikëpamja e leksikut shqipja e asaj kohe ka qenë më e njësishtme se në periudhën e sotme. Të tilla fjalë me përhapje ndërdialektore janë: *bdjerr* (bjerr), *dëreq* ‘drejt’, *dirgjem* ‘zbres’, *dhez* ‘ndez’, *gjegjem* ‘dëgjo’, *gjithëqish*, *gjykatës*, *hinje* (Matrënga *hënjë*), *hirplota* (edhe Matrënga), *krip-i* ‘flokët e kokës’, *ngalkoj* ‘hipi në kalë, shkoj kaluar’, *përderës* ‘lypës’, *popullia*, *prendëverë*, *prire* ‘kthehem’, *shërbes* ‘shërbim, punë’, *e zeshkë* etj.; disa prej tyre gjenden edhe në të folmet e arbëreshëve të Italisë e disa në të Greqisë⁵; ka dhe fjalë që sot janë ruajtur vetëm në toskërishte, p.sh. *përrenjë* (shumësi i *përrua*), *rynj* ‘hyj’, *sokollimë*, *shtuom* ‘në këmbë’ (në toskërishten jugore e në arbërishten e Italisë *shtuara*), *vashëz*.⁶ Ndonjë fjalë si *tëty* ‘të ftohtë’ gjallon sot vetëm në labërishte e në të folmet arbëreshe të Italisë (*tëtim*), ca të tjera në arbërishten e Greqisë, si *gjikatës*, *vgjaj* (edhe në të folmet verilindore)⁷. Në këto përkime të fjalësh të Buzukut me dialektet periferike të toskërishtes marrin pjesë edhe disa huazime greke, si *cihariq* (sihariq), *perivol* ‘kopsht’, *vasiliko* ‘borzilok’.

Krahas kësaj leksiku i veprës dëshmon për atë që gjuha e Buzukut ruan tipare më arkaike se te të tjerët dhe kjo jo vetëm për shkak se ai është më i moçmi, por edhe sepse i përket një dialekti periferik konservator. Fjalë të vjetra e forma të vjetra fjalësh, që përgjithësisht nuk dëshmojnë te autorë të tjerë ose në të folme të ndryshme, janë p.sh.: *agër* ‘gomar’, *agërinjë* e *gare* ‘gomare’, *bëruo* ‘bari’, *dullye* ‘dhembje, hidhërim’, *furrëqi* ‘kurvëri’, *kandër* ‘enë për vaj’, *mangu i sutësë* ‘i vogli i drenushës’, *regëzinj* ‘gris’ etj.; forma

4 Përmendim me këtë rast punimin e Xh. LLOSHIT, *Ndërlikime në leksikun e Gjon Buzukut*. - në: “Studime filologjike” 73(56)/2019, nr. 1–2, f. 19–26.

5 Këto forma të vjetra ruhen pjesërisht në labërishte e çamërishte dhe në të folmet e ngulimeve të diasporës shqiptare; disa prej tyre dalin edhe te autorë të tjerë të Veriut pas Buzukut.

6 Shih këto fjalë edhe te: E. ÇABEJ, “Studime etimologjike në fushë të shqipes” (I–VII). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1975–2014.

7 Shih këto fjalë në vendet përkatëse te blejtë e veprës *Studime etimologjike në fushë të shqipes* të E. Çabejt dhe te artikulli “Gjon Buzuku dhe gjuha e tij” (rev. “Nëntori”, 1955, nr. 3, f. 70–75). Në Shën Mitër (San Demetrio Corone) kam dëgjuar këtë dyvargësh: *Bie borë e bën tëtim, Nga vashëz [çdo vashëz] kërkon një trim*.

të vjetra fjalësh janë, p.sh.: *dardhunë* (derdhun), *shekle* (sheke), *shkalë* (shkelë), *shtu* (ashtu), *shpiert* (shpejt), *i afërë* (i afërt), *i djathë* (i djathtë), *i largë* (i largët), *i le* (i lehtë)⁸.

3. Vështruar nga pikëpamja e burimit të fjalëve që bëjnë pjesë në leksikun e sferës mendore e diturore, bie në sy një numër i madh fjalësh të burimit latin e italian, që zor se mund të quhen huazime të shqipes së shekullit të autorit tonë në kuptimin e gjuhës së përditshme të asaj popullsie të pashkolluar e analfabete, së cilës i shërbente Gjon Buzuku si famullitar. Ato të japin më shumë përshtypjen e një shtrese fjalësh të huaja në përdorim aktiv kryesisht të klerikëve, të “diesve e letërorëve” (siç do t’i quante Budi, duke u ankuar për pakujdesinë e tyre ndaj gjuhës shqipe), por deri diku të njohura edhe për një pjesë të popullsisë që ka pasur lidhje të ndryshme me kulturën dhe jetën e Republikës së Venedikut e me institucionet fetare katolike. Të tilla janë p.sh. **emra** si: *abis*, *abundancie*, *adulterio*⁹, *advent*, *akuilon*, *aliment*, *anatemë*, *apetit*, *avaricie*, *bandierë*, *çenturion*, *çinamon*, *çipres*, *desgracie*, *deskrecionë*, *devocion*, *dezert*, *eksenp*, *eksenpio*, *ereditat*, *fin*, *fior*, *fondament*, *fragjilitat*, *gaxofilacio*¹⁰, *guloz*, *hipokrit*, *kolpë*, *komemoracionë*, *konfin*, *konfort*, *konfesor*, *konfuzion*, *konshience*, *konvënësë*, *libertat*, *luksurie*, *luzione*, *matutin*, *obidiencë*, *obligacione*, *ofertë*, *oktavë*, *olokaust*, *paciencie*, *ostari*, *oste*, *pentekoste*, *perikullë*, *pontifek*, *prokuaratuor*, *proverbie*, *remedie*, *responsorie*, *respostë*, *rumor*, *salute*, *skorpion*, *substancie*, *superbije*, *temporal*, *teremot*, *transfiguracion*, *virgjinitat* etj.; **folje** si: *abituom*, *absolvuom*, *adoruom*, *avancuom*, *biastemuom*, *defenduom*, *delektuom*, *deliberuom*, *desparuom*, *desputuom*, *enpaçuom*, *eredituom*, *fonduom*, *glorifikuom*, *gloriuom*, *justifikuom*, *konfiduom*, *konfirmuom*, *konfortuom*, *konservuom*, *konvertuom*, *liberuom*, *maravejuom*, *minaçuom*, *nunçuom*, *parturuom*, *prezentuom*, *profetixuom*, *purifikuom*, *proveduom*, *rekorduom*, *santifikuom*, *sepeluom*, *skonxuruom*, *strupiuom*, *shtampuom*, *temperuom*, *vendikuom*, *zaminuom* etj; **mbiemra**

8 Mbiemrat *i afërë*, *i largë* i ka edhe Bogdani (khs. K. ASHTA, *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*. “Camaj-Pipa”, Shkodër 2002; A. OMARI, *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit: fjalor i Cuneus Prophetarum me një konkordancë të pjesshme, i paraprirë nga një studim hyrës dhe kritere të fjalorit*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 2016, s.v.). Këta mbiemra janë përfshirë në këtë formë edhe te: S. E. MANN, *A historical albanian-english dictionary*. London, 1948 (me burimet përkatëse) si edhe te *Fjalor i gjuhës shqipe* (Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954), por janë lënë jashtë te *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (Tiranë, 1980), duke u vështruar si të zëvendësuaratashmë në përdorim nga trajtat dytësore *i afërm*, *i afërt*, *i largët* (sipas vëzhgimeve të mia dëgjohen ende në ligjërimin popullor të viseve të Jugut).

9 Buzuku ka ndier nevojën ta shpjegojë: *Mos ban adulterio, qi do me thashunë mos veshte pr udhë të keqe me gruot të shoqit* (XXXVIII/2).

10 Buzuku ka ndier nevojën ta shpjegojë edhe këtë fjalë: *E këto fjalë foli Jezu ndë gaxofilacio, qi do me thanë tuk bane offerta* (LIX).

e ndajfolje si: *i devotë, dupio, fals, fermo, perfet, sakrë, i segurë, sinçero, voluntiera*¹¹.

Por krahas burisë së këtyre fjalëve të huaja vërehet qartë se në shqipen e shekullit XVI po krijohej shtresa e fjalëve të leksikut dituror dhe vetë Buzuku do të ketë dhënë ndihmesë në pasurimin e kësaj shtrese. Nuk mund të thuhet me siguri cilat janë neologjizmat e tij në këtë vepër, por gjithashtu është vështirë të besohet se përkthyesi i një libri të tillë të vëllimshëm të mos ketë krijuar vetë fjalë që i janë dashur, ashtu siç ka kërkuar fjalë të nevojshme edhe në të folme të tjera, pasi përkthimi i një vepre si “Meshari” nuk mund të përballohet me leksikun e kufizuar të një të folmeje. Janë mbajtur pas gjase si krijime të Buzukut fjalë si: *bāsi* ‘factor, kreator’, *burgëtar* ‘i burgosur’, *forcuos* ‘aedificator’, *gojëtareja jonë* ‘advocata nostra’, *i pābesim* ‘incredulus’, *i pāmasë* ‘immensus’, *i pāmort* ‘immortalis’, *i parēlenë* ‘primogenitus’ (dhe sipas kësaj: *i verbēnēlenē, i vetēmnenē*), *e pashërbëtore* ‘ajo që është e lirë, që nuk është robëreshë’, *të pashërbëtyrë* ‘libertate’, *përndjek* ‘persequi’, *përrallësitë* ‘fabulatores’, *shpërblei* ‘redemptor’, *urta* ‘sapientia’, *zemërkëmbiem* ‘pusillus’, *u zemërkeqnë, u zemërmirnë*¹²; por mund të ketë edhe të tjera krijime të tij ndër fjalët me parashtesa e prapashtesa, si *governim, governuos, ndjekës; mortar, i përhirshim, i përmënishim, i përmortshim; përderdhunë, përfaruom, përkujdesun, përlëftuom, përlëvduom*.

Me gjithë këto krijime të vetë Buzukut ose të të tjerëve, vërehet se leksiku i shqipes së asaj kohe kishte mungesë të madhe fjalësh dhe Buzuku ka qenë i shtrënguar të përdorë fjalë të huaja, por ka qenë edhe pak dorëlibër në këtë pikë. Autorët e tjerë, veçanërisht Bogdani, do ta shprehin hapur shqetësimin e tyre për humbjen e fjalëve të vjetra dhe për atë që “gjuha e arbëneshë për të pakë të vet, të madhe pjesë huan gjuhëshit konfinjëtare.”

4. Vështruar nga pikëpamja e fjalëformimit leksiku i Buzukut dëshmon se një numër tipash e mjetesh fjalëformimi nga më të rëndësishmit të gjuhës shqipe kanë vepruar që në atë kohë.

Te klasa e emrave bien në sy fjalët me prapashtesa që shprehin kuptime abstrakte, si *anëmiqi, apostolli, begati, bukuri, diekëqi, fëlliqëni, gjakësi, gjendëni, këmbenji, kurvëni, kusëri, lakëmi, madhështi, miqëni, pleqëni, priftëni, regjëni, shoqëni, tregëti, vëllazëni, vobëzi zotëni* (prap. *-i/-ni*, edhe me kuptim kolektiv); *durim, governim, nderim, ngushullim, predikim, pushim* (prap. *-im*); emra (kryesisht të vepruesit) me prapashtesën *-(ë)s*, si: *detorës, duruos, forcuos, governuos, grabitës, gjakës, gjykatës, hjekës, kënduos, munduos, ndjekës, ngushulluos, ordhënuos, pagëtorës*,

11 Fjalët e mësipërme janë sjellë në formën përfaqësuese (foljet në pjesore) edhe kur kjo nuk dëshmohet te “Meshari”.

12 Shih E. ÇABEJ, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*. - në: “Studime gjuhësore” VI, Prishtinë, 1976; K. ASHTA, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, I. Shkodër, 1996.

përbrendësat, përderës, përrallës, rrenës, shërbes, shkruos, shpërbles, shpëtuos; dalin gjithashtu formime me prapashtesat **-ar**, **-(a)tar**: burgëtar, gojëtare, kurvar, letëtar, peshkëtar, pjesëtar, shtekëtar, tregëtar, udhëtar; **-as**: vendas; **-c(ë)**: përparëce, therëcë; **-eshë**: mikeshtë; **-icë**: buollicë, shumicë; **-(i)më**: bonbullimë, dhezëllimë, frymë, fshamë, krismë, ndimë, sokollimë, vetëtimë; **-inë**: qelbësinë; **-injë**: agërinjë, robinjë; **-or(-uor)**: darsmuor - darsmori, gjatori, kalori, punëtori, zemërori; **-së**: grimësë, ndijesë, pendesë, shembëllesë; **-th**: tambëlth, tfurkth; **-yrë**: pagëtyrë, shembëlltyrë, sherbëtyrë; **-zë**: grishëzë, vashëzë.

Te klasa e mbiemrave bie në sy denduria e mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën **-shim/-çim**, si: *i dishim i ditëshim, i driçim, i duruoshim, i feshim, i mishëriershim e i përmishëriershim, i ndershim, i nevojshim, i ngaeshim, i nmnershim, i përhirshim, i përmënishim, i përmortshim, i rreshim, i shishim* (krahas tyre dalin edhe ndajfolje me këtë prapashtesë, si *eçim, padhimshim, përmëmishim, rreshim*); me prapashtesën **-(ë)t(ë)**: *i artë, i ndryshkët, i vranëtë, i ftofëtë, i letë, i mëndashtë, i ndryshkëtë, i njetë, i unëtë, i unjëtë*; me prapashtesën **-më**: *i mbrapëm, i majm, i sodm, i tepërm*; me prapashtesën **-shkë**: *e zeshkë*. Nga mbiemrat e panyjshëm shënojmë *leshëtar e mortar* me prapashtesat **-tar, -ar**. Bien në sy mbiemrat me prapashtesën **pa-**, që janë rreth 50 (duke përfshirë edhe mbiemrat prejfoljorë), p.sh.: *i pabesë, i pabesim, i pabujtunë, i paçmuom, i padenjë, i padërejtë, i padijtunë, i paemënë, i pafe, i pafrut, i paligjë, i pamort, i panieri, i pashtëpi, i paujë* etj.

Në formimin e foljeve mbizotëron prapashtesa **-o** edhe me variantin **-no**: *bukuruom, faruom, fluturuom, frujtuom, kallëzuom, liruom; kuatënuom* (kuat ‘mëkat’), *zotënuom*. Mjaft aktive del prapashtesa **për-** me funksion kryesisht intensiv: *përdam, përdardhunë, përfaruom, përgëzuom, përglatunë, përgjegjunë, përhikunë, përkuatënuom, përlëftuom, përlëvduom, përpjekunë, përvum, përzënë*.

Te ndajfoljet, përveç prapashtesës **-shim**, që u përmend më lart, del dhe prapashtesa **-sht** te *gërqisht, lëtinisht, xhudhisht*.

Te “Meshari” dalin edhe një numër i mirë kompozitash të tipave të ndryshëm, si: *diekëqi, manëmjedhëra, mjesëditë, mjesënatë, motëmot; dashunëmirë* (dashamir), *diekeq, gojëartë, hirplotë, i parëlenë, i rilenë, i verbënelenë, i vetëmlenë, zemëredëllirë, zemëredërejtë, zemëredhimshim, zemërekeq, zemërkëmyem*.

5. Është me interes më në fund të vështrohet leksiku i “Mesharit” edhe sipas fushave tematike. Sipas natyrës së vetë lëndës, më e pasur del *fusha fetare kishtarë*, me rreth 250 emra, 45 mbiemra dhe po aq folje, pra rreth 340 fjalë ose 16 për qind e fjalëve emërtuese. Në këtë fushë krahas fjalëve të përgjithshme të brumit të shqipes ose me burim nga latinishtja, si *bagmi, këreshmë, klishë, kuat, lter, munëk, pashkë, prift, shpirt, ungjill; i kërshenë, i lum, mortar; besuom, bekuom, mallëkuom, konguom, ordhënuom, pagëzuom*

etj., ka edhe një numër të madh huazimesh italiane, si *adoratuor, advent, devocion, dezert, divinitat, komemoracionë; adoruom, absolvuom, çelebruom, glorifikuom* etj.

Duke kaluar tani në paraqitjen e fushave tematike për pjesët emërtuese të ligjëratës (ndajfoljet nuk janë klasifikuar), vërejmë se ato janë mjaft të larmishme si për leksikun e sferës së mendimit e të ndjenjave, ashtu edhe për leksikun konkret.

Përveç fushës fetare kishtare, te **emrat** kemi dalluar edhe këto fusha tematike: 1) ekonomia shtëpiake, bujqësia, blegtoria, peshkimi: 55 emërtime; familja e farefisnia: 25; njeriu në përgjithësi, gjymtyrët e pjesët e trupit: 70; gjendje fiziologjike e shpirtërore të njeriut: 30; mjeshtëri, funksione e tipare të njeriut 42; morali e sjellja: 17; shtëpia dhe banimi, sende e orendi shtëpiake: 40; veshmbathje: 13; botanika: 35; zoologjia 53; relievi e mjedisi, organizimi i territorit: 32; ushqimi: 25; dukuri natyrore e meteorologjike, astronomi: 31; moti dhe koha në përgjithësi: 25; mjete të ndryshme, lëndë, metale: 31; ushtria dhe lufta: 18; masa: 10; monedha: 3; muzika 7; etnonime: 4; nocione të përgjithshme abstrakte (si *bukuri, dhunë, fat, mëndyrë, abundancie, autoritat* etj.) 80; marrëdhënie shoqërore e nocione juridike: 35; mbiemra prejfoljorë të emëruar: 40.

Te **mbiemrat** vendin e parë e zënë gjithashtu fjalët e fushës fetare kishtare (*i bekuom, hirplote, i pafe, i pakuat* etj.): 50; tipare e cilësi pozitive a negative: 80; cilësi fizike (*i artë, i madh, i thatë*); tipare morale: 15; cilësi të gjendjes fiziologjike e shpirtërore: 25; tipare hapësinore e sasiore: 20; tipare kohore: 5; tipare ngjyrash: 8; këtyre u shtohen edhe rreth 100 mbiemra prejpjesorë, që shkojnë me fushat tematike të foljeve përkatëse.

Edhe te **foljet** ka rreth 50 fjalë të sferës fetare kishtare. Mjaft e pasur është fusha e veprimeve të përgjithshme të njeriut (*bam, bdjerrë, marrë, fëjyem, guxuom, prekunë, pushuom, rrahunë* etj.), si edhe e veprimeve intensive (*përfaruom, përgëzuom, përpjekunë* etj.): 75; në fushën bujqësi, blegtori, peshkim: 14; procese fizike, meteorologjike: 20; veprimtaria fiziologjike, shpirtërore e emocionale: 45; sjellje në shoqëri: 23; lëvizja: 30; veprimtari juridike: 7; veprime punësh të ndryshme: 20; veprimtari intelektuale: 16; marrëdhënie familjare, ekonomike, profesionale: 7; të folurit e të biseduarit: 9; huazime letrare të sferës së përgjithshme të kulturës: 47; përveç këtyre edhe disa fusha me pak njësi, si: të ngrënët e të gatuarit: 8; të banuarit: 2; ndryshime sasiore: 4; të veshur e të mbathur: 3; lidhje familjare: 2; veprime kohore: 2, etj.

Nga sa u shtjellua deri këtu shihet se, ndonëse te “Meshari” i Buzukut del vetëm një pjesë e leksikut të shqipes së mesit të shekullit XVI, ajo vepër sjell një lëndë të pasur për të gjykuar për shkallën e zhvillimit të këtij leksiku në kohën kur gjuha shqipe po kapërcente periudhën parashkrimore për të hyrë në periudhën e lëvrimit e të zhvillimit si gjuhë kulture. Me gjithë

punën e lavdërueshme të Kolë Ashtës e të Thoma Qendros për nxjerrjen e leksikut të “Mesharit”, hartimi i një fjalori të ri të kësaj vepre me struktura më të plota kuptimore të fjalëve e me të dhëna sasiore për shfaqjen e tyre mbetet si detyrë për studimet e mëtejshme rreth gjuhës së Gjon Buzukut si përfaqësues i shqipes së mesit të shek. XVI.